



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës**

NDËRMARRJA SHËRBIMEVE KOMUNALE Durrës

Nr. _____ prot

Durrës, më _____. _____. 2025

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

Sherbimi i pastrimit te Njesise Administrative Ishëm

Numri i referencës së procedurës/Lotit (eve): REF: 58198-08-15-2025

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

45111213-4; 45111220-6; 90611000-3; 98341130-5

VLERA E FONDIT LIMIT:

Fondi limit/Vlera e pritshme e marreveshjes kuader: **56,695,639 (pesedheje e gjashte million e gjashteqind e nentdhjete e pese mije e gjashteqind e tridhjete e nente) lekë pa tvsh ose 583,528.6 (peseqind e ttedhjete e tre mije e peseqind e njezet e tete pike gjashte) Euro pa TVSH** (sipas kembimit valutor te Bankes Kombetare Shqiptare date 12.08.2025-13.08.2025).

Vlera e pritshme e kontrates vjetore: 18,898,546.4 (tetembedhjete million e teteqind e nentdhjete e tete mije e peseqind e dyzet e gjashte pike kater) lekë pa tvsh ose 194,509.5 (njeqind e nentdhjete e kater mije e peseqind e nente pike pese) Euro pa TVSH (sipas kembimit valutor te Bankes Kombetare Shqiptare date 12.08.2025-13.08.2025).

Arsyetimi pse procedura nuk mund te ndahet ne lote:

Në bazë të nenit 39 të Ligjit Nr. 162/2020 “ Për Prokuriminin Publik i ndryshuar dhe nenit 39, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar, ku citohet se: “Autoriteti kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rast se vendos të zhvillojë procedurën e prokurimit pa e ndarë në lote, duhet të parashikojë një përcaktim të arsyeve kryesore për këtë vendim, i cili bëhet pjesë e dosjes së tenderit”. Autoriteti/enti kontraktor Ndërmarrja Shërbimeve Komunale Durrës ka vendosur që procedurën të mos e ndajë në lote për arsyet si më poshtë:

Së pari, kemi të bëjmë me një njësi shërbimi pastrimi, siç është Njësia Administrative Ishem ku sipërfaqja e saj nuk është aq e madhe sa ta ndajmë në lote dhe të shërbejnë më shumë se 2 operatorë.

Se dyti, ashtu sic parashikohet dhe ne specifikimet teknike dhe grafiku i levrimit kerkohet nje mjet transporti autoagregat, nje mjet transporti kamion te haput, nje autobot dhe nje fadrome, rrjedhimisht nuk ka vend per ndarje ne lote te ketij sherbimi

Si pasojë e këtyre dy faktoreve kemi gjykuar që kryerja e shërbimit të pastrimit në Njësine Administrative Ishem, Bashkia Durrës, të kryhet në një lot.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Ndërmarrja Shërbimeve Komunale Durrës ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, i ndryshuar, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 **Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

2.1.1 OE duhet të deklarojë se ka në stafin e tij punonjesit e kërkuar për kryerjen e shërbimit, të punësuar, e vërtetuar me listë pagesat për periudhën Maj 2024 e në vazhdim si më poshtë:

- **1 Drejtues Teknik, me profil Inxhinier, i cili i shërben qëllimit të procedurës së prokurimit, (Të jetë i pajisur me certifikatë lëshuar nga Ministria përkatëse) për të cilin duhet të paraqesë:**
 - Kontratë pune të vlefshme (përkatëse)
 - Diplomë
 - Libreze Pune
- 2(dy) shofer vërtetuar me kontratë pune të vlefshme të ndare si më poshtë:
 - 1 Shofer kamioni i pajisur me Leje Drejtimi përkatëse për shofer kamioni dhe me Certificate Aftësi Profesionale (ÇAP)
 - 1 Manovratore (Eskavatoriste) të pajisur me Dëshmi Aftësi Profesionale lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor.
- Një punësim i të paktën 14 (katërmbëdhjetë) punonjësish ku të përfshihen (drejtuesi teknik, Shofertet, punonjës të transportit, grumbullimit, fshesës dhe grëritjes), si dhe të figurojnë të punësuar pranë shoqërisë shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtme:
 - Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për muajin Korrik 2025 e në vazhdim.
 - Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislati në fuqi.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP i ndryshuar, nenin 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" e ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Kërkesa e Autoriteti Kontraktor që Operatori Ekonomik duhet të ketë në stafin e tij inxhinier në rolin e drejtuesit teknik është në funksion të realizimit të kontratës duke patur parasysh natyrën e shërbimit duke qenë se kemi të bëjmë me evadimin e mbetjeve urbane.

Referuar llojit të shërbimit të kërkuar, duket qartazi domosdoshmëria për specialistë të nevojshëm të cilët kanë aftësinë dhe formimin profesional, dhe që janë specializuar për t'i kryer ato.

Numri i përcaktuar i punonjësve është për llogaritur si më poshtë:

Duke iu referuar llojit të shërbimit si dhe eksperiencës së ndërmarrjes ndër vite në evadimin e mbetjeve në njësine administrative në fjalë, është llogaritur që për kryerjen e këtij shërbimi

nevojiten 14 punetore te thjeshte nga te cilet 5 (pese) punetore grumbullues, krefes mbetjesh, 1 (nje) punetore fshesare, dhe 5 (pese) punetore transporti, 2 (dy) shofere transporti+ boti+ fadrom Gjithashtu per te organizuar punen e tyre nevojitet 1 (nje) drejtues teknik me profesion inxhinier duke qene se kemi te bejme me pastrim mbetjesh urbane.

(shënim: plotësoni nëse është rasti, aktin konkret ligjor ose nëligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale në fjalë).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2022, 2023, 2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 20% e vlerës së fondit limit**. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 20% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Në përcaktimin e vlerës së xhiros autoriteti kontraktor është referuar në pikën 2, gërma (c) të Nenit 43, Seksioni III të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohej, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet forms elektronike".

(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore).

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: (2022, 2023, 2024) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri

audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislationit të fushës, konkretisht në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislationit tatimor, ku përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese).

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit **nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës**, në vlerën **jo më pak se 20% e vlerës së fondit limit të këtij loti**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ose faturat tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislationit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislationit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe nenin 41, pika 3 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 30 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Referuar nenit 55 pika 4 gërma b e VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, është përcaktuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 30 % të vlerës së fondit limit, për të vërtetuar aftësitë teknike të OE me qëllim përmbushjen nevojave të Autoriteti Kontraktor.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohej, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

2.3.2 Operatori Ekonomik duhet të disponojë Licence leshuar nga Qendra Kombetare e Biznesit (QKB) :

- *Kategoria:* Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis.
- *Kodi:* III.2.B
- *Emertimi pershkrues i veprimtarisë:* Grumbullim e transportim i mbetjeve jo të rrezikshme.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar nënenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar si dhe VKM Nr.538, datë 26.5.2009 Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (qkl) dhe disa rregulime të tjera nënligjore të përbashkëta.

(shënim- përcaktoni aktin ligjor ose nënligjor specifik dhe nenin përkatës, që parashikon licencimin e subjekteve, në lidhje me veprimtarinë përkatëse për realizimin e shërbimeve objekt kontrate).

Me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

(shënim- nëse është rasti, shtoni argumentimin nga ana teknike për nënlojin/kodin/kategoritë e kërkuara të licencës përkatëse, bazuar në shërbimet objekt kontrate)

2.3.3. Operatori ekonomik duhet të disponojë:

- Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me certifikatë **ISO 9001 – 2015** “Për sistemin e menaxhimit të cilësisë” lëshuar nga institucione të akredituara për ushtrimin e aktivitetit objekt i këtij prokurimi. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë certifikatën ISO sipas zerave që merr persiper të kryeje) ose ekuivalente.
- Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me certifikatë **ISO 14001 – 2015** ”Për Sistemin e menaxhimit të mjedisit” lëshuar nga institucione të akredituara për ushtrimin e aktivitetit

objekt i këtij prokurimi (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë certifikaten ISO sipas zerave që merr persiper të kryeje) ose ekuivalente.

- Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me certifikatë **ISO 45001-2018**, për kushtet e sigurise dhe të shendetit të punonjesve, lëshuar nga institucione të akredituara për ushtrimin e aktivitetit objekt i këtij prokurimi (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë certifikaten ISO sipas zerave që merr persiper të kryeje) ose ekuivalente.

Argumentimi: Kriteri që OE duhet të disponojë Certifikate ISO 9001-2015 ose ekuivalente me të, "Për sistemin e menaxhimit të cilësisë", është kërkuar për të siguruar që OE disponon një sistem të organizuar të menaxhimit të cilësisë së shërbimit që ofron.

Kriteri që OE duhet të disponojë Certifikatën ISO 14001:2015, ose ekuivalente me të "Për Sistemin e menaxhimit të mjedisit", lëshuar nga institucione të akredituara për ushtrimin e aktivitetit objekt i këtij prokurimi, është kërkuar për të siguruar që OE disponon një sistem të organizuar të menaxhimit të mjedisit.

Kriteri që OE duhet të disponojë Certifikatën ISO 45001-2018, për kushtet e sigurise dhe të shendetit të punonjesve, është kërkuar për të siguruar që OE disponon një sistem të qe garanton kushtet e sigurise dhe të shendetit në punë.

2.3.4. Operatori Ekonomik duhet të deshmojë se ka mjetet dhe paisjet teknike për të kryer këto shërbime, si më poshtë:

<i>Mjetet</i>	<i>Sasia</i>	<i>Gjendja</i>
Makinë teknologjike për grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve me kapacitet mbajtës mbi 16 m3 Ton (per kazane 1100 lt)	1 copë	Pronësi ose me qira
Makinë vetëshkarkuese me kapacitet mbajtës mbi 8 Ton	1 copë	Pronësi ose me qira
Fadrome për ngarkim mbetjesh të inerteve	1 copë	Pronësi ose me qira
Autobot për larje kazanesh	1 copë	Pronësi ose me qira
Kazan me kapacitet 1100 lt	150 copë	Pronësi ose me qira

- Mjetet në pronësi duhet të shoqërohen me dokumentacionin: Certifikatë Pronësie, Leje Qarkullimi, Kontroll Teknik, Sigurim, Taksat Vjetore, të vlefshme, si dhe të shoqëruar me foto të secilit mjet ku të jetë e dallueshme targa e mjetit dhe karakteristikat e tij.*
- Mjetet me qira duhet të shoqërohen me kontratë qiraje si dhe me aktin e pronësisë së qiradhënësit (origjinal ose kopje e noterizuar). Kontrata e qirasë duhet të përmbajë*

objektin dhe afatin e marrjes me qera të mjeteve (e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi) si dhe e shoqëruar nga dokumentacioni i plotë i cdo mjeti përkatës dhe foto të secilit mjet ku të jetë e dallueshme targa e mjetit dhe karakteristikat e tij.

- c) *Per kazanet e mbetjeve urbane Operatori Ekonomik ne rastin pronesise duhet te paraqese faturen e blerjes se tyre, ose ne rastin e marrjes me qera te tyre te paraqitet kontrata e marrjes se kazaneve me qera e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi.*

Argumentimi: Autoriteti Kontraktitor kërkon që Operatori Ekonomik duhet të disponojë keto mjete per kryerjen e shërbimit te evadimit te mbetjeve urbane ne njesine administrative Ishem. Duke nisur nga llogaritjet e mbetjeve qe kjo njesi gjeneron mesatarisht gjate vitit eshte llogaritur qe nevojiten mjetet e listuara ne tabelen e mesiperme. Gjithashtu nevojiten 150 kazane 1100 litra, te cilet sipas relievit te njesise si dhe numrit te banoreve qe ka kjo njesiketo kazane mbetjesh jane me te pershtatshmet.

- 2.3.5 Operatori ekonomik qe paraqet oferten duhet të disponojë një mjedis toke truall në pronësi ose me qira brenda territorit administrativ te Bashkise Durres per zhvillimin e ketij aktiviteti (ne formen e kerkuar nga ligji, me çertifikatë pronësie nëse është në pronësi, me kontrate qeraje pranë zyrës noteriale nëse është marrë me qera e shoqeruar me certifikaten e pronesise te qiradhenesit). Operatori ekonomik ne truallin ne pronesi ose me qera duhet te disponoje nje pompe me presion te larte (pompe lavazhi) per larjen e makinerive si dhe per larjen e kazaneve. (ne formen e kerkuar nga ligji, me fature blerje, me kontrate qeraje pranë zyrës noteriale nëse është marrë me qira).

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe nenit 41, pika 4/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Kerkesa qe OE te disponoje nje siperfaqe toke e cila vjen si nevojte per parkimin e mjeteve nese eshte e nevojshme, por edhe per riparime te ndryshme qe mund te kene nevojte kazanet e mbetjeve, si dhe te gjitha paisjet e tjera te punes. Kerkesa qe OE ne kete siperfaqe toke te kete edhe nje pompe lavazhi ne menyre qe te jete e mundur larja e kazaneve sipas kerkesave ne specifikimet teknike dhe ne termat e references.

(Shënim- shtoni argumentimin nga ana teknike për nevojën për mjetet dhe pajisjet e kërkuara, për realizimin e kontratës).

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, i ndryshuar, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Hartimi i specifikimeve teknike është kryer duke iu referuar statistikave dhe përvjes se ndermarrjes si dhe te nevojave qe njesia administrative ka. Gjithashtu i jemi referuar edhe përvjes se pergjegjesve dhe brigadiereve qe kane punuar ne kete njesi administrative ne sektorin e pastrimit.